



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

Nr. 7801/5 Prot.

Tiranë, më 11.09. 2018

Lënda: Njoftim

OPERATORIT EKONOMIK "ASLV" SHPK

**Adresa: Rruga "Komuna Parisit",
Kompleksi "Kika 2", Godina 9,
njësia Nr. 10 dhe njësia Nr. 11,
kati përdhe, Tiranë.**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në mbështetje të kërkesës së Bashkisë Korçë, me shkresën Nr. 7801/1 Prot., datë 23.08.2018 ka nisur procedimin administrativ ndaj operatorit tuaj ekonomik, për përjashtimin tuaj nga pjesëmarrja në prokurimet publike, në mbështetje të nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Po me këtë shkresë, ju është kërkuar të paraqisni pretendimet me shkrim, së bashku me dokumentacionin shoqërues të njehsuar dhe argumentimet përkatëse që mund të keni për çështjen në fjalë.

Kjo shkresë nuk ka arritur në destinacion dhe është kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare.

Në këto kushte, APP me shkresat Nr. 7801/2 Prot., datë 28.08.2018 dhe Nr. 7801/3 Prot., datë 31.08.2018 ka përsëritur njoftimin e fillimit të procedimit administrativ drejtuar operatorit tuaj ekonomik, por edhe këto shkresa janë kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare, për shkak të ndryshimit të adresës së shoqërisë tuaj.

Nga verifikimi i Ekstraktit historik të shoqërisë tuaj në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton të jetë pasqyruar vendimi datë 03.09.2018 për hapje/mbyllje adrese dytësore, duke shtuar adresën: *Rruga "Komuna Parisit", Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njësia Nr. 10 dhe njësia Nr. 11, kati përdhe, Tiranë.*

Në këto kushte, APP me shkresën Nr. 7801/4 Prot., datë 06.09.2018 ka përsëritur njoftimin drejtuar shoqërisë tuaj në rrugë shkresore në adresën e shtuar të ushtrimit të aktivitetit, por edhe kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare, pasi adresa juaj e re është cilësuar e panjohur.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi publik APP njofton shoqërinë tuaj se, në bazë të parashikimeve të nenit 45 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, rezervoni të drejtën për t’u njohur me provat e administruara në kuadër të procedimit administrativ të nisur ndaj shoqërisë tuaj, duke dërguar kërkesën me shkrim, ***brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike***, në të kundërt APP do të vijojë procedimin administrativ në bazë të dokumentacionit të administruar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

